**VENDIM**
**Nr.446, datë 27.4.2006**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR "TV LEZHA"**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të "Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të vendimit nr.426, datë 21.3.2006 të KKRT-së, të Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.030/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, personin fizik z.Fred Stakaj për televizionin "TV Lezha".
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 3.1.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Halil Lalaj**